

REGJISTRI I RI JANAR-MARS

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundi mit të kërkesës	Tarifa
2133	29.12.2021	Kerkese per informacion mbi investimet e parashikuara ne objektet kulturore pergjate vitit 2022	13.01.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), me Nr.2133 Prot., datë 29.12.2021, lidhur me investimet e parashikuara ne objektet kulturore përgjate vitit 2022, ju bëjmë me dije se: IKTK ka paraqitur në Projekt Buxhetin Afatmesëm (PBA) 2022-2024, një listë me projektet për investime nga Buxheti i Shtetit për vitin 2022. Pas miratimit të Buxhetit të vitit 2022 për cdo Ministri, në IKTK deri më tani është hapur vetëm Buxheti i shpenzimeve korente. Për shpenzimet kapitale/investimet, buxheti detajohet nga Ministria e Kulturës për institucionet e varësise, brenda muajit shkurt. Sapo ky buxhet të ketë ardhur, IKTK e bën transparent për publikun në faqen zyrtare të saj.	E plote	JO
30	11.01.2022	Kerkese per informacion			E plote	JO
31	11.01.2022	Kerkese per informacion	24.01.2022	Në vijim të kërkesës suaj, administruar pranë Institutit Kombëtar	E plote	JO

				të Trashëgimisë Kulturore me Nr.31 Prot., datë 11.01.2022, për vënien në dispozicion të informacionit lidhur me gjëndjen e disa monumenteve/mozaikë që gëzojnë statusin Monument Kulture kategoria I, ju bëjmë me dije se: Bazuar në pikën 3 të nenit 15 të Ligjit Nr. 119/2014 " Për të drejtën e informimit", duke konsideruar volumin e konsiderueshëm të informacionit, gjithashtu pritjen e kthim përgjigjeve nga ana e institucioneve të tjera, ju njoftojme për shtyrjen e marrjes së informacionit me 5 ditë pune kohë. <i>Duke ju falenderuar paraprakisht për mirëkuptimin,</i>		
65	14.01.2022	Kërkesë për Informacion mbi Monumentin e Kulturës "Muret e Portës", Durrës	02.02.2022	Në vijim të kërkesës suaj, administruar pranë IKTK me Nr. 64 Prot., datë 14.01.2022, Bazuar në pikën 3 të nenit 15 të Ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, duke konsideruar volumin e madh të informacionit, kërkojme shtyerjen e marrjes së informacionit me 5 dite pune kohë.	E plote	Jo
338	22.02.2022	Komisioneri per te drejten e informimit	25.02.2022	Në vijim të kërkesës suaj, administruar pranë IKTK me Nr. 64 Prot., datë 14.01.2022, mbi kërkesën për informacion lidhur me Monumentin e Kulturës Ju bëjmë me dije se: Subjekti ka aplikuar për shqyrtim dhe vendimarrje pranë KKR dhe KKA sipas vendime bashkëlidhur.	E plote	Jo

				Vendimi i KKA nr3, date 24.01.2017 përcakton lidhjen e akt-marrëveshjes 3-palëshe për monitorim arkeologjik, në vijim të të cilit ASHA i ka përcjellë subjektit së bashku me vendimin edhe draftin e aktmarrëveshjes. Deri në këtë moment subjekti zhvillues nuk është paraqitur pranë Institucionit për nënshkrimin e akt-marrëveshjes. Nga ana e specialisteve të DRTK Tiranë, e cila ka ne administrim territorin ku gjendet monumenti "Muri i Portes", është kryer inspektimi në terren dhe është konstatuar se subjekti ka vijuar punimet pa monitorim. Për këtë arsye DRTK Tiranë i është drejtuar Inspektoriatit Kombëtar të Ndërtimit dhe IMTT Durrës për pezullimin e punimeve sipas shkresës bashkëlidhur. Në lidhje me ndryshimet në projekt të miratuara në vitin 2018 nga KKT, sqarojmë se nga ana e Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë nuk ka vendimmarrje tjetër vec asaj të vitit 2017 (Vendim nr3, date 24.01.2017), ndërsa në Këshillin Kombëtar të Restaurimit është miratuar me Vendim Nr.330, datë 27.07.2018. Në mbështetje të Ligjit Nr.27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", është përgjegjësi e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Tiranë, e cila monitoron gjëndjen e pasurive kulturore në territorin që ata administrojnë.		
--	--	--	--	--	--	--

				Bashkëlidhur gjeni kopjen e vendimit të KKA Nr.3, datë 24.01.2017 dhe KKR nr.330, datë 27.07.2018.		
31/1	31.01.2022	Rikërkesë për informacion	01.02.2022	Lutemi gjeni bashkelidhur shkresat kthim-pergjigje te dy kerkesave tuaja per informacion.	E plotë	JO
email	14.12.2021	Kerkese per informacion	01.02.2022	Në përgjigje të shkresës suaj dërguar me email me datë 14.12.2021, ne lidhje me kerkesen per informacion te Znj.E. A. , Ju bëjmë me dije se: Gjatë tërmetit të datës 26.11.2019 janë inspektuar 111 objekte nga ana e specialistëve të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe janë përcaktuar 55 objekte të dëmtuara nga tërmeti. Nga këto 55 objekte janë hartuar projektet e restaurimit për 38 prej tyre dhe për 7 objekte ka filluar puna e restaurimit dhe 3 janë në proces të fillimit. Deri tani kanë përfunduar 2 objekte. Për objektin Muzeu Etnografik Durrës, me emërtimin Banesa “Aleksandër Moisiu” (Muzeu Etnografik) është miratuar në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale me Vendim Nr. 518, datë 22.12.2020, për të cilën pritet investime nga donatorët.	E plote	JO
36	12.01.2022	Kërkesë për informacion	24.01.2022	Në vijim të kërkesës suaj, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr.36 Prot., datë 12.01.2022, për vënien në dispozicion të informacionit lidhur me gjëndjen e disa monumenteve/mozaikë që gëzojnë statusin	E plotë	Jo

				Monument Kulture kategoria I, ju bëjmë me dije se: Bazuar në pikën 3 të nenit 15 të Ligjit Nr. 119/2014 " Për të drejtën e informimit", duke konsideruar volumin e konsiderueshëm të informacionit, gjithashtu pritjen e kthim përgjigjeve nga ana e institucioneve të tjera, ju njoftojme për shtyrjen e marrjes së informacionit me 5 ditë pune kohë.		
36/1		Kërkesë për informacion	01.02.2022	Lutemi gjeni bashkëlidhur shkresën kthim përgjigje të kërkesës suaj për informacion. Duke ju falenderuar për mirekuptimin dhe bashkëpunimin,	E plotë	Jo
44	13.01.2022	Kërkesë për informacion	14.01.2022	Lutem gjeni bashkëlidhur, shkresën e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Nr. 44 Prot., datë 13.01.2022 "Kërkesë për informacion në kuadër të hartimit të raportit për gjendjen e konservimit të pasurisë botërore "Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e Rajonit të Ohrit", si dhe materialin bashkëlidhur të cituar në shkresë. Lutemi bashkëpunimin Tuaj për dërgimin e informacionit të kërkuar brenda datës 19 janar 2022 (e mërkurë) në adresën zyrtare info@iktk.gov.al.	E plotë	Jo
64	14.01.2022	Kërkesë për informacion	26.01.2022	Në vijim të kërkesës suaj, administruar pranë IKTK me Nr. 64 Prot., datë 14.01.2022, mbi kërkesën për informacion lidhur me Monumentin e Kulturës Ju bëjmë me dije se:	E plotë	JO

				Subjekti ka aplikuar për shqyrtim dhe vendimarrje pranë KKR dhe KKA sipas vendime bashkëlidhur. Vendimi i KKA nr3, date 24.01.2017 përcakton lidhjen e akt-marrëveshjes 3-palëshe për monitorim arkeologjik, në vijim të të cilit ASHA i ka përcjellë subjektit së bashku me vendimin edhe draftin e aktmarrëveshjes. Deri në këtë moment subjekti zhvillues nuk është paraqitur pranë Institucionit për nënshkrimin e akt-marrëveshjes. Nga ana e specialisteve të DRTK Tiranë, e cila ka ne administrim territorin ku gjendet monumenti "Muri i Portes", është kryer inspektimi në terren dhe është konstatuar se subjekti ka vijuar punimet pa monitorim. Për këtë arsye DRTK Tiranë i është drejtuar Inspektoriatit Kombëtar të Ndërtimit dhe IMTT Durrës për pezullimin e punimeve sipas shkresës bashkëlidhur. Në lidhje me ndryshimet në projekt të miratuara në vitin 2018 nga KKT, sqarohet se nga ana e Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë nuk ka vendimarrje tjetër vec asaj të vitit 2017 (Vendim nr3, date 24.01.2017), ndërsa në Këshillin Kombëtar të Restaurimit është miratuar me Vendim Nr.330, datë 27.07.2018. Në mbështetje të Ligjit Nr.27, datë 17.05.2018 "<i>Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë</i>", është përgjegjësi e		
--	--	--	--	--	--	--

				Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Tiranë, e cila monitoron gjëndjen e pasurive kulturore në territorin që ata administrojnë. Bashkëlidhur gjeni kopjen e vendimit të KKA Nr.3, datë 24.01.2017 dhe KKR nr.330, datë 27.07.2018.		
email	19.01.2022	Kërkese për informacion	27.01.2022	Bashkëlidhur, lutem gjeni kthim-përgjigjen në lidhje me informacionin e kërkuar mbi kalatë.	E plotë	JO
email	25.01.2022	Kërkesë sygjerim	02.02.2022	Në vijim të kërkesës Suaj lidhur me sugjerimin për shpalljen monument kulture, për objektin "Kisha e Shën Dhimitrit në fshatin Palasë", Ju bëjmë më dije se: IKTK do ta marrë në konsideratë sugjerimin e bënë nga ju dhe do të ndjekkë hap pas hapi të gjitha procedurat sipa Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” për vlerësimin e interesit kulturor të objektit. Për sa më sipër do ju informojme në vazhdim. Duke ju falënderuar për interesin,	E plotë	Jo
173	02.02.2022	Kërkesë për material arkivor	14.02.2022	Në vijim të kërkesës Suaj Nr. 11 Prot., datë 31.01.2021, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr.173 Prot., datë 02.02.2022, Ju bëjmë më dije se, për objektin “Kalaja e Tepelenës” disponojmë projektet restauruese dhe ndërhyrjet ndër vite	E plotë	JO

			si më poshtë: ☐ Projekt restaurimi, viti 1982; ☐ Projekt restaurimi, viti 1983; ☐ Relacion teknik dhe preventiv dhe projekt restaurimi (burgu), viti 1984; ☐ Projekti i Sterave, viti 1985; ☐ Projekt azhurnimi i viteve 1984- 1985; ☐ Relacion teknik mbi punimet përforcuese dhe ripërtëritëse në kala dhe preventiv i vitit 1986; ☐ Relacion teknik dhe preventiv i viteve 1988, 1989; ☐ Projekt restaurimi i vitit 1990; ☐ Projekt restaurimi i vitit 1995; ☐ Projekt restaurimi i vitit 2011; ☐ Projekt restaurimi i vitit 2012; ☐ Projekt rikonstruksion i sheshit të kalasë Tepelenë, viti 2014; ☐ Projekt “Sistemimi i kalasë së Tepelenës”, viti 2015; ☐ Projekt “Punime pastrimi dhe konsolidimi të mureve fortifikuese të Kalasë së Tepelenës”, viti 2020. Mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur kopje të dokumentacionit të vjetër fotografik të periudhave të ndryshme të kalasë, me të dhënat përkatëse vitin dhe autorin, që ka realizuar foton, si dhe dy planimetri të kalasë të viteve 1983, 1985 në format elektronik (CD). Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).		
--	--	--	---	--	--

221	09.02.2022	Kërkesë për informacion	16.02.2022	Në përgjigje të kërkesës Suaj me datë 09.02.2022, administruar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), me nr. 221 prot., datë 09.02.2022, lidhur me kërkesat për të shpallur në mbrojtje për statusin “monument kulture” të disa objekteve në fshatin Lekël, Tepelenë, Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: IKTK-ja në planin vjetor për vitin 2022, ka të parashikuar verifikimin e interesit kulturor në objektet “Kompleksi i objekteve të mesjetës, të fisit të rilindësit kombëtar Anstas Byku”, “Shkolla e Leklit, e hapur në vitin 1860 nga bamirësi Vangjel Zhapa”, “Kisha e Shën Kollit në lagjen Cërrikë”, Lekël, Tepelenë. Në vijim të respektimit të planit të punës vjetor, grupi teknik do të marrë masa duke verifikuar në terren interesin kulturor për objektet e sipërpërmendura, si dhe do të shqyrtohet gjendja e përgjithshme dhe vlerat e zonës. Më pas, do të ndiqen procedurat administrative në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.	E plotë	JO
254	14.02.2022	Kërkesë për informacion	17.02.2022	Në përgjigje të kërkesës Suaj administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), me nr. 254 prot., datë 14.02.2022, lidhur me kërkesë për informacion dhe kërkesë për mosdhënie leje ndërtimi, leje zhvillimi, PDV apo çdo lloj aprovimi për ndërtime apo shtesa në zonën rreth pasurisë nr. 6/42, Ju bëjmë me dije se: Së pari IKTK-ja rikonfirmon se ndërtesa ku	E plotë	JO

				ka pasur qendrën organizata “Bashkimi” në kohën e revolucionit të qershorit, mban statusin “monument kulture” i kategorisë së parë, i shpallur me vendim të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, nr. 1886, datë 10.06.1973. Ky objekt sipas hartës treguese të regjistrimit të depozituar nga ana juaj, ndodhet në zonën kadastrale nr. 8150, me nr. pasurie 6/42, Rr. “Xhorxhi Martini”, nr. 12 në qytetin e Tiranës dhe përbëhet nga një truall dhe objekt 3 kate. Përsa i përket dhënies së lejeve të ndërtimit, lejeve të zhvillimit, apo çdo lloj aprovimi për ndërtime apo shtesa në zonën rreth pasurisë nr. 6/42, ju sqarojmë se IKTK-ja nuk është institucioni kompetent për dhënien e këtyre lejeve, por është institucion publik që ushtron kompetencat në bazë të ligjit shqiptar, për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë. Pranë IKTK-së funksionon sekretaria teknike e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), i cili është një organ kolegjal vendimmarrës pranë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ka kompetencë të miratojë lejet për ndërhyrjet me karakter ruajtës e mbrojtës të pasurive kulturore të paluajtshme pra objekteve që kanë status monument kulture, sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018 për “Trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Në lidhje me kërkesën për informacion nga ana juaj mbi miratimin e PDV të hartuar nga ana e Bashkisë Tiranë në zonën TR/349, ju informojmë se pranë		
--	--	--	--	---	--	--

				IKTK-së nuk është depozituar ndonjë kërkesë e tillë. Sa i përket kërkesës suaj për përcaktimin e zonës së mbrojtur rreth monumentit të kulturës ju informojmë si më poshtë vijon: Bazuar në ligjin nr. 27/2018 për “Trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, neni 96, pika 1, masat e mbrojtjes indirekte përcaktohet: Adresa: Rr. “Aleksandër Moisiu” Nr. 76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë, Shqipëri, Tel.:+355 4 45 04 152, Email: info@iktk.gov.al,www.iktk.gov.al “Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në lidhje me pasurinë kulturore të paluajtshme, si dhe Këshilli i Ministrave, për grupimin e pasurive kulturore të paluajtshme, kanë kompetencë të përcaktojnë zonën mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme, veçmas ose të grupuara, perspektivën, dritën, kushtet mjedisore dhe peizazhin. Aktualisht nuk ka ende një akt nënligjor të miratuar nga Këshilli i Ministrave, në lidhje me përcaktimin e zonave mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin, në zbatim të pikës 1, nenit 96, të këtij ligji. Gjithashtu ligji nr. 27/2018 për “Trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, neni 278, shfuqizime, pika 3, 4 përcaktojnë: “3. Aktet nënligjore të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të		
--	--	--	--	---	--	--

				ndryshuar, dhe ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005, “Për muzetë”, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien ndesh me të, do të zbatohen derisa nuk janë miratuar aktet nënligjore të parashikuara në këtë ligj. 4. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005, “Për muzetë”, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për sa kohë nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.” Për sa më sipër urdhëri nr. 297, 31.07.2015 i Ministrit të Kulturës për shpalljen e zonave të mbrojtura të monumenteve të kulturës, mbetet në fuqi dhe pika 1 e këtij urdhëri përcakton: “Zona e mbrojtur e monumentit të kulturës konsiderohet sipërfaqja e truallit Brenda kufirit të pronës në të cilin ndodhet monumenti”.		
299	17.02.2022	Kërkese per material arkivor	02.03.2022	Në vijim të kërkesës Suaj datë 15.02.2022, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr. 299 Prot., datë 17.02.2022, mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur kopje të dokumentacionit arkivor për objektin “Kalaja e Krujës”, si më poshtë: - Pamje e hyrjes së kalasë, viti 1966; - Planimetri e kullës pranë hyrjes, viti 1966; - Plani i kalasë, viti 1976.	E plotë	JO

				Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).		
327	18.02.2022	Kërkesë per material arkivor	01.03.2022	Ne vijim te kerkeses suaj, date 18.02.2022, administruar prane IKTK me Nr. 327, date 18.02.2022, per hulumtim ne arkivin teknik te IKTK, lutemi jeni te mirepritur per t'u konsultuar me dokumentacionin arkivor qe disponojme per tre objektet qe keni ne proces studimi.	E plotë	JO
353	22.02.2022	Kërkesë per material arkivor	02.03.2022	Në vijim të kërkesës Suaj datë 21.02.2022, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr.353 Prot., datë 22.02.2022, mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur kopje të dokumentacionit arkivor për objektin “Kalaja e Triportit dhe muri antik në det”, Zvërnec, Vlorë si më poshtë: - Rilevim topografik i vendbanimit, viti 1982; - Planimetri e skelës, viti 1982; - Planimetri ekzistuese, viti 1987. Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plotë	JO
email	25.02.2022	Kerkese per material arkivor mbi nderhyrjet stabilizuese ne Kalane e Krujes,	04.03.2022	Ne vijim te kerkeses Suaj date 25.02.2022, ju bejme me dije se ne arkivin teknik te IKTK nuk disponojme dokumentacion teknik te viteve 1990-1997, mbi nderhyrjet stabilizuese ne shkembnin ne hyrje te kalase se Krujes.	E plotë	JO

email	03.03.2022	Kerkese per materiale ne arkive	04.03.2022	kthim pergjigje Bashkelidhur gjen shkresen kthim pergjigje dhe materialet ne link per dergim https://we.tl/t-8WEVDV3oKe	E plotë	JO
email	03.03.2022	Kërkesë për material arkivor	04.03.2022	Bashkelidhur ju dergoj shkresen kthim pergjigje dhe materialet ne link https://we.tl/t-MERiPrWXLx	E plotë	JO
468	10.03.2022	Kërkesë për material arkivor	15.03.2022	Në vijim të kërkesës Suaj, datë 10.03.2022, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr. 468 Prot., datë 10.03.2022, në mbështetje të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije se Arkivi Teknik nuk disponon materiale që mund t’i përgjigjen kërkesës tuaj.	E plotë	JO
483	15.03.2022	Kërkesë për informacion	23.03.2022	Në vijim të shkresës Suaj, datë 09.03.2022, administruar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) me Nr. 483 Prot., datë 15.03.2022, në lidhje me kërkesën për përditësimin e projektit të restaurimit hartuar nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Ju bëjmë me dije se: IKTK-ja brenda kompetencave të saj, ka përfshirë në planin e punës për vitin 2022 rishikimin e projektit të banesës Galanxhi, e cila gëzon statusin pasuri kulturore, monument kulture	E plotë	JO

				kategoria e I-rë, shpallur me Urdhër Nr.1886, datë 10.06.1973. Përsa i përket, investimit për zbatimin e punimeve të restaurimit në përputhje me projektin e hartuar, ju informojmë se bazuar në dispozitat e ligjit nr. 27/2018 për “Trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, Neni 20 “Financimi për trashëgiminë kulturore”, pika 1,2 “Fondet për restaurimin e trashëgimisë kulturore sigurohen nëpërmjet buxhetit të shtetit, buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe çdo burimi tjetër të ligjshëm nga persona juridikë apo fizikë, vendas ose të huaj, përfituar në formën e donacioneve ose sponsorizimeve.” Për sa më sipër IKTK-ja, nuk është institucioni përgjegjës për investimin në këto projekte dhe nuk ka të parashikuar në buxhetin e saj fond për zbatimin e punimeve në banesën Galanxhi. Gjithashtu, DRTK Gjirokastrë, të vijojë me marrjen e masave brenda parashikimeve të ligjit nr. 27/2018 për “Trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.		
484	15.03.2022	Kërkesë për material arkivor	17.03.2022	Në vijim të kërkesës Suaj datë 15.03.2022, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr.484 Prot., datë 16.03.2022, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju	E plotë	Jo

				vendosim në dispozicion bashkëlidhur në link materialet qe kemi për objektin “ Banesa Aleksandër Avrami” Korçë		
327/2	17.03.2022	Kërkesë për material arkivor	24.03.2022	Në vijim të kërkesës Suaj datë 15.03.2022, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr.327/2 Prot., datë 17.03.2022, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur në link https://we.tl/t-9DzPcVqynd kopje të materialit arkivor referuar listës së objekteve të përzgjedhura pas hulumtimit tuaj pranë arkivit teknik, përkatësisht si më poshtë: - Foto historike të vitit 1966, 1967 për objektin nr. 264 “<i>Termat antike</i>”, Durrës; - Foto historike të vitit 1966, 1974, 1981 për objektin nr.267 “<i>Mozaiku i gruas bukuroshes</i>”, Durrës. Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plotë	JO
522	17.03.2022	A ka ndonje zhvillim te ri me problematiken e Ures se Matit, per te parandaluar shembjen totale te saj?	29.03.2022	Ne vijim te kerkeses date, 17.03.2022, ku kerkohet informacion mbi ecurine e zgjidhjes se problematikes se objektit pasuri kulturore “Ura e Matit”, Ju informojme se: Ne vijim te kerkeses se Agjencise se Menaxhimit te Burimeve Ujore per caktimin	E plotë	Jo

				e eksperteve nga cdo institucion, me qellim bashkepunimin nder institucional ne nivel ekspertesh per te percaktuar shkaqet qe kane sjelle demtimin e objektit pasuri kulturore, si dhe indentifikimin e masave emergjente dhe afatgjata qe duhen ndermarre per eliminimin e shkaqeve e pasojave, Instituti Kombetar i Trashegimise Kulturore, ka shprehur gadishmerine me percaktimin e specialisteve (pjese te stafit te IKTK) qe do t'i bashkohen grupit te punes. Per sa me siper, IKTK mbetet ne dispozicion ne momentin qe do te kerkohet kontributi I eksperteve te saj lidhur me ceshtjen.		
email	17.03.2022	Kërkesë për informacion takim	29.03.2022	Kthim përgjigje	E plotë	JO
523	18.03.2022	Kerkese per informacion per vendndodhjen e objektit brenda zones arkeologjike	23.03.2022	Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 111 Prot., datë 17.03.2022, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr. 523 Prot., datë 18.03.2022, lidhur me “Kërkesë për informacion për projektin me objekt: “LOT 8 Design and Supervision for Reconstruction and Repair/Retrofitting of educational facilities, located in Durrës and Tirana Municipalities”, “EU4Schools” Programme”, konfirmojmë se të dy objektet, përkatësisht Kopshti Kuçok, Manëz dhe Konvikti i shkollës së mesme teknike “Beqir Çela”, Durrës, ndodhen jashtë zonave arkeologjike A dhe B, të qytetit të Durrësit, në përputhje me VKM-në Nr. 786, datë	E Plotë	Jo

				26.12.2018 “Për miratimin e Zonave Arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Durrësit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”. Për informacione dhe referenca të mëtejshme mund të konsultoheni me platformën Webgis Arkeologjia: http://arkeologjia.iktk.gov.al/ASHA/Pages/M.aspx		
538	23.03.2022	Kërkesë për informacion	27.03.2022	Në përgjigje të shkresës Suaj me datë 22.03.2022, administruar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), me nr. 538 prot., datë 23.03.2022, lidhur me kërkesën për verifikim të interesit kulturor të disa objekteve në fshatin Lekël, Tepelenë, Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore ka një plan të miratuar për çdo vit kalendarik sipas prioriteteve dhe emergjencave të parashikuara. IKTK-ja do të vijojë gjatë muajit qershor me verifikimin e interesit kulturor në objektet “Kompleksi i objekteve të mesjetës, të fisit të rilindësit kombëtar Anastas Byku”, “Shkolla e Leklit, e hapur në vitin 1860 nga bamirësi Vangjel Zhapa”, “Kisha e Shën Kollit në lagjen Cërrikë”, Lekël, Tepelenë, sipas planit të punës për vitin 2022. Në vijim të respektimit të planit të punës vjetor, grupi teknik do të marrë masa duke verifikuar në terren interesin kulturor për objektet e sipërpërmendura, si dhe do të shqyrtohet gjendja e përgjithshme dhe vlerat e zonës. Më pas, do të ndiqen procedurat	E plotë	JO

				administrative në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “ <i>Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë</i> ”.		
596	30.03.2022	Kerkese : Per material teknik dhe grafike per objektin me kodin K-141		Në proces		
598	30.03.2022	Kerkese per material ne arkive		Në proces		